



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

MIDIS

**AUTORITETEVE TË INVESTIGIMIT TË
AKSIDENTEVE DHE INCIDENTEVE AJRORE NË
AVIACIONIN CIVIL TË VENDEVE TË
MËPOSHTME**



**REPUBLIKA E
SHQIPËRISË**

dhe



**REPUBLIKA E
KOSOVËS**

**NË LIDHJE ME BASHKËPUNIMIN DHE ASISTENCËN
NË INVESTIGIMET E AKSIDENTEVE DHE
INCIDENTEVE AJRORE NË AVIACIONIN CIVIL**



1. HYRJE

1.1 Ky Memorandum Bashkëpunimi (MB) shpreh mirëkuptimin e:

**Organit Kombëtar të Investigimeve të Aksidenteve/Incidenteve
Ajrore në Aviacionin Civil (OKIAC) të Shqipërise
dhe
Komisionit të Hetimit të Aksidenteve dhe Incidenteve
Aeronautike (KHAIA) të KOSOVËS**

Këtej e tutje referuar si Palët në këtë MB, përsa i përket bashkëpunimit dhe asistencës në fushën e investigimeve të aksidenteve dhe incidenteve të rënda në aviacionin civil.

1.2 Palët në këtë MB ndjekin rregullat e vendosura në Marrëveshjen e Çikagos dhe Zonës së Përbashkët Ajrore Europiane dhe si pasojë janë të kufizuar sipas standarteve të përfshira në Aneksin 13 – Investigimi i Aksidenteve dhe Incidenteve Ajrore të ICAO dhe Regullores 996/10 të BE mbi investigimin dhe parandalimin e Aksidenteve dhe Incidenteve në avcicionin civil.

1.3 Palët në këtë MB janë të autorizuar nga qeveritë respektive të veprojnë si Autoritete Investiguese Shtetërore që përfaqsojnë Shqipërinë dhe Kosovën, përsa i përket çështjeve të investigimeve të aksidenteve dhe incidenteve ajrore në aviacionin civil.

1.4 Ky MB përcakton rregullimet proceduriale për bashkëpunimin dhe asistencën midis palëve.

2. TERMINOLOGJIA

2.1 Fjalët dhe frazat e përdorura në këtë document kanë të njëjtin kuptim siç janë përshkruar në Aneksin 13 – Investigimi i Aksidenteve dhe Incidenteve Ajrore të ICAO dhe Regullores 996/10 të BE.

3. QËLLIMI I INVESTIGIMEVE

3.1 Qëllimi i Investigimeve të Aksidenteve dhe Incidenteve në përputhje me Aneksin 13 është parandalimi i Aksidenteve dhe Incidenteve. Nuk është qëllimi i këtyre investigimeve të përcaktojnë faje dhe përgjegjësi.



4. KODI I SJELLJES

- 4.1 Ky MB shërben për të përkrahur bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjelltë midis palëve në zbatim të Aneksit 13 dhe rregullave të BE në lidhje me parrezikshmërinë në aviacion. Secila palë duhet të përpiqet të tejkalojë vështirësitë që mund të lindin si pasojë e ndryshimeve ligjore apo vendndodhjes gjeografike.

5. SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

- 5.1 Secila palë do të formojë një grup pune me specialistë për të planifikuar dhe zbatuar bashkëpunimin midis tyre në fushën teknike përsa i përket fushës së Investigimeve të Aksidenteve dhe Incidenteve në aviacionin civil. Këto shkëmbime teknike do të përfshijnë diskutimet që kanë për qëllim të përmirësojnë aftësitë investigative të organeve respektive, si edhe qëllimin dhe zgjerimin e asistencës që mund të jepet nën kushte të caktuara.
- 5.2 Shkëmbimet dhe bashkëpunimet midis palëve duhet gjithashtu të mbulojnë trajnime për stafin investigativ, duke përfshirë pjesëmarrjen në kurse trajnimi.

6. ASISTENCA PËR SHTETIN E NGJARJES

- 6.1 Kur njëra palë, që vepron si Shteti i Ngjarjes, i kërkon palës tjetër asistencë teknike për një investigim që kryhet sipas Aneksit 13, përgjigja duhet të koordinohet midis palëve të përfshira. Palët duhet të punojnë së bashku për të siguruar që një investigim i përshtatshëm të bëhet në përputhje me procedurat dhe qëllimin e Aneksit 13.
- 6.2 Secila palë mund të kërkojë informacion në lidhje me përparimin e ndonjë investigimi që bëhet nga pala tjetër. Duhet bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të dhënë informacionin e kërkuar. Në përputhje me ligjet respektive në fuqi, një informacion i tillë duhet trajtuar minimalisht me të njëjtin konfidencialitet dhe kushte si ato që kufizojnë dhe palën dhënëse.



7. KOORDINIMI

7.1 Personi i kontaktit për palët respektive si më poshtë:

<i>Emri</i>	<i>autoriteti</i>	<i>adresa</i>	<i>tel</i>	<i>fax</i>	<i>email</i>
	OKiia	Tirana			
	KHAIA	Prishtina			

8. PËRFUNDIMI

8.1 Ky MB do të hyjë në fuqi në datën që nënshkruhet nga palët, dhe do të qëndrojë në fuqi deri kur njëra nga palët kërkon përfundimin e saj. Kërkesa për përfundimin e këtij MB duhet të bëhet minimalisht tre muaj para datës në të cilën kërkohet të përfundohet ky MB.

Nënshkruar më..... *01 Nëntor 2012* në Tiranë.

<i>Autoriteti</i>	<i>Shteti</i>	<i>Emri</i>	<i>Pozicioni</i>	<i>firma</i>
OKiia	Republika e Shqipërisë	Dipl.Ing. Arben XHIKU	Drejtor i Përgjithshëm	
KHAIA	Republika e Kosovës	Mr. Kreshnik GASHI	Kryesues	